

**KONTRATË**  
**SHITJE PASURIE E LUAJTSHME**

Në Durrës, sot më datë **08.06.2021**(dymijë e njetete e nje) palët bënë redaktimin e Kontratës si me poshtë:

-Shitësi: **Shoqëria "Verrocchi Group" srl**, shoqëri e themeluar në Itali, përfaqësuar nga administratori dhe ortakut i vetëm i shoqërisë Z. Valerio Verrocchi.

- Blerësi: **Z. Besnik Kurti**, lindur më 26.08.1981 në Durrës, Shqipëri dhe banues në Lagjen nr.15, Durrës, Shqipëri, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. Personal **ID. I10826058J**

Shitësi dhe Blerësi janë referuar me poshtë individualisht si "Pala" dhe se bashku si "Palët".

**DEKLARATA PARAPRAKË:**

I.Shoqëria "**Verrocchi Group**" sh.p.k, është një shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në QKB, me datë 08/05/2018 , me nr. NIPT. **L81708048N**, me seli në DURRES Rruga "Skenderbej", Zona Kadastrale 8514, Pasuria Nr.4/33-N38, Volumi 34, Faqe 201. (**Shoqëria**)

II.Kapitali i Shoqërisë është 100,000(njëqind mije )Lekë, i ndarë në

- a) Z. Besnik Kurti, zotërues i një kuote sa 66% të kapitalit të shoqërisë dhe,
- b) Shoqëria "Verrocchi Group" srl, shoqëri e themeluar në Itali, përfaqësuar nga administratori dhe ortakut i vetëm i shoqërisë Z. Valerio Verrocchi, zotërues i një kuote sa 34% të kapitalit të shoqërisë,

III.Shitësi është pronari i ligishëm i 1(një) kuote sa 34% (tridhjetë e kater përqind) te kapitalit te Shoqërisë me vlere 34,000 (Tridhjetë e kater mije)Leke

IV.Duke u mbështetur ne ligjin nr .9901 date 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me Vendimin te ortakut Nr.080621, date **08.06.2021** , ka vendosur

- 1. Transferimin e 1(nje) kuote me vlerë nominale 10,000 (dhjete mije) Lekë sa 10 % të kapitalit tek me ane te shitjes Shoqëria "Verrocchi Group" srl, shoqëri e themeluar në Itali, tek bleresi (z. Besnik Kurti)


V.Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit dhe Blerësi dëshirone te blejë nga Shitësi kuotën Palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj kontrate për shit-blerjen e kuotave nëpërmjet Shitësit dhe Blerësit ("**Kontrata**"), si më poshtë vijon:

**Neni 1**

**Objekti i Kontratës**

1.1 Ne datën e nënshkrimit te kësaj Kontrate ("**Data e Nënshkrimit**"), Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blene nga Shitësi kuotat si me poshte vijon

- a) **Shitësi** shet **1 (nje)** kuote sa **10%**(dhjete perqind) e kapitalit me vlere nominale **10,000** (Dhjete mije) Leke tek **bleresi z. Besnik Kurti**.  
Cmimi i rene dakord për shitjen e **1 (një)** kuote sa **10 %** (dhjetë përqind) te kapitalit te Shoqërisë me **10,000** (Dhjete mije) Leke është **10,000** (Dhjete mije) Leke



1.2 Shitësi duhet të përfundojë dhe dorëzojë, dhe/ose të bëjë të mundur përfundimin dhe dorëzimin e dokumenteve të tjerë të nevojshëm sipas legjislacionit shqiptar, në mënyrë që t'i kalojë Blerësit një titull të mirë dhe të tregëtueshëm mbi kuotat dhe për të përmbushur sic duhet qëllimin e kësaj Kontrate.

1.3 Shitësi dhe Blerësit bien dakord për të përfunduar dhe dorëzuar me kërkesë të palës tjetër dhe/ose Shoqërisë çdo dokument të nevojshëm në përgjithësi për të bërë gjithçka është e nevojshme për të regjistruar kuotat e transferuara subjekt të kësaj Kontrate në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të autoriteteve shqiptare të kërkuara sipas legjislacionit shqiptar.

1.4 Kuotat transferohen nga pronësia e Shitësit në pronësi të Blerësit në Datën e Nënshkrimit.

1.5 Pagesa e Cmimit të përcaktuar në Nenin 1.2. është kryer dorazi.

## Neni 2 Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit

2.1 Shitësi deklaron dhe garanton në lidhje me transaksionin që parashikohet në këtë Kontratë, për të gjitha çështjet që vijojnë.

2.1.1 *Autorizimi* — Te gjitha veprimet, aktet dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe/ose aktet e Shoqërisë që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Shitësit dhe \_\_\_\_\_ që autorizojnë Shitësin të lidhë dhe të zbatojë këtë Kontratë janë kryer rregullisht; kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Shitësi dhe përben një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për Shitësin dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.

2.1.2 *Nënshkrimi* — Nënshkrimi i kësaj Kontrate nuk kërkon asnjë depozitim, miratim, autorizim të çfarëdo lloji nga ndonjë autoritet shtetëror ose pale e trete.

2.1.3 *Mungesa e konfliktit* — Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Kontrate nuk janë dhe nuk do të jenë në konflikt ose nuk do të rezultojnë në ndonjë shkelje a mos përmbushje, të ndonjë kontrate, marrëveshje apo dispozitave të një vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të detyrueshme për Shitësin.


2.1.4 *Detyrimet tatimore* të cilat rrjedhin nga transferimi i aksioneve me anë të shitjes sipas kësaj kontrate dhe që mbliidhen sipas legjislacionit shqiptar, në rast se do të ketë të tilla, do të paguhen nga shitësi.

## Neni 3 Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit

3.1 Blerësit bëjnë deklaratimet dhe i jep garancitë e mëposhtme Shitësit.

3.1.1 *Autorizimi* — Te gjitha veprimet, aktet dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe / ose aktet e Shoqërisë që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Blerësit dhe që autorizojnë Blerësin të lidhë dhe të zbatojë këtë Kontratë janë kryer rregullisht. Kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Blerësi dhe përben një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për Blerësin dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.

3.1.2 *Mungesa e konfliktit* — Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Kontrate nuk janë dhe nuk do të jenë në konflikt, ose nuk do të rezultojnë në ndonjë shkelje apo mos përmbushje, të ndonjë kontrate, marrëveshjeje apo dispozitave të një vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të detyrueshme për Blerësin.



**Neni 4**  
**Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni kompetent**

4.1 Kjo Kontrate rregullohet nga ligjislacini Shqiptar.

4.2. Çdo konflikt ne lidhje me, interpretimin, zbatimin, zgjidhjen, përfundimin e Kontratës do te zgjidhet nga juridiksioni kompetent giyqësor shqiptar.

**Neni 5**  
**Te ndryshme**

5.1 Ndryshimet

5.1.1 Çdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqie dore nga ndonjë prej dispozitave te kësaj Kontrate, do te jete e vlefshme vetëm nëse behet me shkrim, me akt noterial dhe nënshkruhet nga ose ne emër te secilës Pale.

5.1.2 Mosushtrimi ose vonesa në ushtrimin e një të drejte ose mase mbrojtje, që parashikohen në këtë Kontrate ose nga ligji, nuk përben heqie dore nga e drejta ose masa e mbrojtjes, ose heqie dore nga te drejta ose masa te tjera mbrojtjeje. Mosushtrimi i vetëm ose i pjesshëm i një te drejte ose mase mbrojtjeje qe parashikohen ne këtë Kontrate ose nga ligji, nuk pengon ushtrimin e mëtejshëm te se drejtës ose masës mbrojtëse ose ushtrimin e një te drejte ose mase tjetër mbrojtjeje.

5.2 Vlefshmëria e pavarur nga njëra tjetra e dispozitave kontraktore

Ne rast se një dispozite ose detyrim sipas kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm ne një juridiksion, vlefshmëria, ligishmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve te tjera, ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve ne një juridiksion tjetër, nuk do te preket nga një fakt i tille.

5.2.1 Palët do te përpiqen te zëvendësojnë një dispozite te pazbatueshme ose te pavlefshme, ne masën me te madhe te mundshme, për te arritur qëllimin e kësaj dispozite.

5.3 Kopjet

5.3.1 Kjo Kontrate nënshkruhet ne 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe

5.4 Asnjera palë nuk mund të kalojë dhe / ose te transferoje te drejtat dhe / ose detyrimet sipas kësaj Kontrate, ne tërësi ose ne veçanti, pa miratimin paraprak me shkrim te Palës tjetër.

5.5 Kjo Kontrate përben marrëveshjen e plote dhe zëvendëson çdo marrëveshje te mëparshme midis Palëve qe lidhet me objektin e kësaj Kontrate.

**SHITËSI**

Verrocchi Group SRL

përfaqësuar nga

Z. Valerio Verrocchi

**VERROCCHI GROUP SRL**  
Via Porto Nuovo, 2  
70122 BARI  
P. IVA 08001840720

**BLERËSIT**

Z. Besnik Kurti

*Besnik Kurti*